

Nr. K1/I204-17 Prot.
Nr. Dok. 202401585/17

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çatave me asbesti dhe mbrojtjen e banorëve në lagjen "Jani Vruho", Berat

BASHKISË BERAT

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT

INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË BERAT

**DREJTORISË RAJONALE TË OPERATORIT TË SHERBIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR BERAT**

Për dijeni:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

PREFEKTIT TË QARKUT BERAT

ZYRËS RAJONALE TË AVOKATIT TË POPULLIT BERAT

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar me iniciativë ndjekjen e problematikës së prezantuar në median e shkruar investigative¹ ku është bërë prezente problematika në lagjen "Jani Vruho" të qytetit të Beratit, ku jeton kryesisht komuniteti egjiptian. Një pjesë e madhe e banesave kanë mbulesa çatie të ndërtuara me materiale që përmbajnë asbest (të njohur si eternit), të cilat prej vitesh janë klasifikuar se kanë efekte kancerogjene. Ky material, i përdorur gjerësisht para viteve 1990 për mbulim çatie, tashmë ka filluar të degradohet për shkak të ekspozimit ndaj agentëve atmosferikë si shiu dhe dielli. Ekspertët, e kanë cilësuar situatën si një "minë me sahat", pasi degradimi i vazhdueshëm i materialit po e bën rrezikun

¹ <https://www.reporter.al/2024/10/07/asbesti-ne-catite-e-banesave-rrezikon-jeten-e-banoreve-te-beratit/>

më të madh me kalimin e kohës. Ata kanë theksuar nevojën për ndërhyrje profesionale në heqjen e asbestit, sepse procesi i heqjes pa masat e duhura teknike është edhe më i rrezikshëm. Për këtë arsye, banorët janë këshilluar të mos e largojnë vetë asbestin, por të presin ndërhyrjen e strukturave shtetërore. Kjo qasje e ka lënë të zgjatur problemin, ndërkohë që organizata si "Drejtësi Sociale" dhe përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian kanë kërkuar zgjidhje konkrete nga bashkia, duke përfshirë projekte rehabilitimi dhe financime për heqjen e asbestit. Banorët, të përballur me rreziqe të vazhdueshme shëndetësore dhe pa mjete për të zgjidhur problemin vetë, ndihen të braktisur dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të mbrojtur jetën e tyre dhe atë të fëmijëve të tyre. Situata paraqet problematikë të rëndë të të drejtave të njeriut, që cenon të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të sigurt, në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për sa më lart, për qëllime të hetimit administrativ lidhur me problematikën e sipërcituar, fillimisht i jemi drejtuar me një kërkesë zyrtare për informacion dhe shpjegime Bashkisë Berat, ku janë kërkuar të dhëna për masat e ndërmarra, bashkëpunimet me institucione të tjera dhe nëse janë ofruar alternativa strehimi për banorët e prekur. Më pas, pas marrjes së një përgjigjeje nga bashkia, Avokati i Popullit ka zgjeruar hetimin duke i drejtuar kërkesa për informacion edhe institucioneve të tjera, konkretisht Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat-Elbasan-Korçë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Qëllimi i këtij hetimi administrativ ka qenë të vlerësojë përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, përputhshmërinë e veprimeve të tyre me legjislacionin në fuqi dhe të nxisë marrjen e masave konkrete për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të banorëve të kësaj lagjeje, duke siguruar një mjedis jetese të sigurt dhe të shëndetshëm.

Një pjesë e institucioneve kanë kthyer përgjigje me informacion të pjesshëm dhe të fragmentuar, ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka kthyer asnjë përgjigje zyrtare pavarësisht se kërkesa për informacion dhe shpjegime i është adresuar dy herë².

Bashkia Berat, me shkresën nr. 6164/1, datë 26.11.2024 shprehet se është në dijeni të rrezikut që kjo situatë përbën për shëndetin e banorëve. Ajo deklaron se e ka ndjekur çështjen në terren dhe ka vendosur në dijeni institucionet e tjera si Policia, IKMT dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit, por e konsideron trajtimin e asbestit si çështje jashtë kapaciteteve të saj operationale, duke theksuar se aktualisht menaxhon vetëm mbetjet urbane dhe se nuk ka ofruar alternativa specifike strehimi për banorët më të ekspozuar ndaj rrezikut, përveç përfshirjes në një program të përgjithshëm për përmirësimin e kushteve të banesave, ku, siç pranohet vetë nga bashkia, shumica e familjeve nuk përfitojnë për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë.

Drejtoria Vendore e Policisë në Berat, me shkresën nr. 258/1, datë 16.01.2025, ka konfirmuar se ka kryer verifikime në terren dhe ka evidentuar banesat që përmbajnë asbest, në bashkëpunim me përfaqësues të komuniteteve rom dhe egjiptian, duke i dërguar Avokatit

² Shkresat nr. 202401585/5, dt.23.12.2024 dhe 202401585/7, dt.04.02.2025 të Avokatit të Popullit drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

të Popullit një listë të emrave të banorëve përkatës, por pa informuar për ndonjë masë të mëtejshme operationale apo referim të rastit në strukturat përkatëse.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë, me shkresat nr. 1759/1, datë 30.12.2024 dhe 125/1, datë 27.01.2025 sqaron se në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi kompetencat e saj kufizohen vetëm në subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari të licencuar dhe që janë të pajisur me leje mjedisore. Për këtë arsye, ARM e përjashton veten nga çdo përgjegjësi apo ndërhyrje në situata që kanë të bëjnë me banesa private apo të paformalizuara. Ajo rekomandon që informacionet dhe përgjegjësitë për rastin konkret t'i kërkojnë IKMT-së dhe vetë Bashkisë Berat, duke lënë të kuptohet se nuk ka ndërmarrë dhe nuk planifikon ndonjë veprim të drejtpërdrejtë lidhur me problemin e konstatuar.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, me shkresat nr. 1110/1, datë 18.02.2025, nr. 1110/3, datë 07.04.2025, si dhe nr. 1110/5, datë 21.02.2025, i është drejtuar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Berat, e për dijeni Drejtorisë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Berat, me kërkesën për informacion mbi statusin ligjor të banesave që përmbajnë asbest, por krahas kësaj nuk ka pasur veprime apo përgjigje të mëtejshme kundrejt kërkesës për shpjegime të Avokatit të Popullit.

Verifikimi në terren

Me qëllim verifikimin konkret dhe të drejtpërdrejtë të problematikës së raportuar në lagjen “Jani Vruho” të qytetit të Beratit, Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Zyrës Rajonale Berat, ka vendosur kontakt me organizatat lokale të shoqërisë civile që veprojnë në këtë zonë, veçanërisht me ato që punojnë me komunitetet rom dhe egjiptian. Në bashkëpunim me këto organizata, është kryer një **verifikim në terren i situatës aktuale**, nga i cili rezultoi se një numër i konsiderueshëm banesash janë ende të mbuluara me pllaka çatie që përmbajnë asbest (të njohura si eternit), të ndërtuara dekada më parë dhe tashmë të degraduara rëndë për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm ndaj kushteve atmosferike.

Gjatë verifikimit janë evidentuar raste të ndërhyrjeve të pakontrolluara mbi këto çati nga vetë banorët, të cilët, për shkak të mungesës së informacionit dhe mjeteve financiare, kanë kryer riparime ose mbulime shtesë pa asnjë masë mbrojtëse, duke rritur rrezikun e shpërndarjes së fibrave kancerogjene në mjedis. Veçanërisht shqetësues është fakti se përballë disa prej këtyre banesave ndodhet edhe shkolla 9-vjeçare “Shyqyri Lakra”, çka e rrit ndjeshëm ekspozimin e fëmijëve ndaj këtij materiali të rrezikshëm. Banorët, të shqetësuar dhe të pambështetur nga strukturat publike, kanë shprehur frikën për shëndetin e tyre dhe të familjarëve, ndërkohë që nuk ka pasur ndonjë ndërhyrje konkrete nga autoritetet vendore për t'i informuar apo për të marrë masa për sigurinë mjedisore e shëndetësore në këtë zonë.

Vlen të theksohet se përfaqësuesja e institucionit ka vërejtur një ndjenjë të theksuar frike dhe pasigurie mes banorëve gjatë bashkëbisedimeve të zhvilluara në terren. Shumë prej banorëve kanë shprehur ankthin e përditshëm që përjetojnë për shëndetin e tyre dhe të familjarëve, sidomos për fëmijët, ndërkohë që ndihen të braktisur nga autoritetet publike. Disa prej banorëve të intervistuar janë persona me sëmundje kronike ose me histori të

mëparshme sëmundjesh të rënda, të cilët shprehen se ndihen vazhdimisht të kërcënuar nga prania dhe degradimi i çatave të mbuluara me materiale që përmbajnë asbest. Një ndër to është një grua e mbijetuar nga kanceri i gjirit, e cila deklaroi se ndihet e pambrojtur dhe në rrezik të përhershëm për shkak të çatisë së banesës së saj, e ndërtuar me eternit, dhe se prej vitesh askush nga autoritetet nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta ndihmuar. Një tjetër banorë, që vuan nga astma bronkiale, pretendon se gjendja e saj shëndetësore është përkeqësuar si pasojë e ekspozimit të zgjatur ndaj asbestit që ndodhet në çatinë e shtëpisë ku banon.

Po ashtu, gjatë verifikimit në terren u konstatua se në asnjë prej objekteve të mbuluara me materiale që përmbajnë asbest nuk ishte vendosur ndonjë tabelë paralajmëruese për rrezikun që paraqet ky material për shëndetin e banorëve dhe të komunitetit përreth. Mungesa e sinjalizimit vizual në objektet e rrezikshme përbën një mangësi serioze në përmbushjen e detyrimeve minimale të informimit dhe mbrojtjes së publikut. Gjithashtu, nuk u evidentua asnjë përpjekje nga autoritetet vendore për të shpërndarë materiale informuese mbi natyrën e rrezikut nga asbesti, mënyrën e ekspozimit dhe pasojat e mundshme shëndetësore. Banorët e pyetur deklaruan se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion zyrtar për këtë çështje, nuk janë kontaktuar nga autoritetet për ndonjë masë paraprake dhe nuk kanë dijeni për ndonjë plan apo strategji institucionale për menaxhimin e rrezikut, përveç kontaktit nga Drejtoria Vendore e Policisë e cila, pas kërkesës për shpjegime nga Avokati i Popullit, ka kryer verifikime në terren dhe ka evidentuar banesat që përmbajnë asbest, listë të cilën ia ka përcjellë dhe Avokatit të Popullit.

Për më tepër, u konstatua se nuk është zhvilluar asnjë seancë informuese ose ndërgjegjësuere për komunitetin nga ana e bashkisë, qendrës shëndetësore ose strukturave të tjera shtetërore, ndonëse rreziku është i njohur dhe i vazhdueshëm.

Nga pamjet e administruara gjatë verifikimit në terren në lagjen “Jani Vruho” të qytetit të Beratit, vërehet qartë një gjendje e rënduar e objekteve të mbuluara me çati që përmbajnë material asbesti (eterenit), i cili duket i degraduar, i thyer dhe i ekspozuar ndaj agentëve atmosferikë. Dëmtimet në strukturën e mbulesave tregojnë për një nivel të avancuar konsumimi, çka shton ndjeshëm rrezikun për përhapjen e fibrave të rrezikshme në mjedis. Në disa raste, mbi panelet ekzistuese janë vendosur llamarinat metalike ose elementë të tjerë mbulues, me synimin për të parandaluar hyrjen e ujit, por këto ndërhyrje janë bërë në mënyrë të paautorizuar dhe pa respektuar asnjë standard mbrojtës, duke rritur rrezikun për dëmtim të mëtejshëm të materialit të asbestit dhe përhapjen e tij në ambient. Gjithashtu, në pjesën më të madhe të objekteve të fotografuara, shihet qartë se nuk janë vendosur tabela paralajmëruese për rrezikun që paraqet prania e këtij materiali. Nuk vërehet asnjë masë mbrojtëse për të kufizuar kontaktin fizik apo për të informuar banorët për ndalimin e ndërhyrjeve me mjete amatore. Këto pamje konfirmojnë në mënyrë vizuale atë që është vënë re dhe dokumentuar gjatë vëzhgimit në terren: mungesë e masave mbrojtëse dhe informuese nga autoritetet publike, një gjendje të përkeqësuar të materialeve ndërtimore që përmbajnë asbest dhe një rrezik real dhe i vazhdueshëm për shëndetin e banorëve – veçanërisht për fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. Në disa raste, janë të dukshme edhe pranë banesave elementë të zakonshëm të jetesës së përditshme (karrige,

tenda, rroba të varura), gjë që dëshmon për jetesë të përhershme dhe ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj materialit të rrezikshëm.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton mungesë të theksuar të bashkërendimit ndërinstitutional dhe tendencë për të shmangur përgjegjësinë nga secili prej institucioneve të përfshira në këtë proces, duke e zhvendosur barrën e përgjegjësisë tek institucionet e tjera. Pavarësisht se të gjitha institucionet janë vënë në dijeni të një situate të rëndë që cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin dhe sigurinë e një komuniteti të tërë, asnjëri prej tyre nuk ka ndërmarrë hapa konkretë për të garantuar ndërhyrjen e nevojshme për eliminimin e rrezikut. Informacionet e dhëna janë të pjesshme, përgjithësisht justifikuese dhe pa orientim drejt zgjidhjes së problemit.

Bashkia Berat ka qenë në dijeni të problematikës si dhe e ka verifikuar atë në terren, por e ka cilësuar trajtimin e asbestit jashtë kapaciteteve të saj operacionale. Shumë familje nuk mund të përfitojnë as nga programet e përgjithshme të rehabilitimit të banesave, për shkak të mungesës së dokumenteve të pronësisë (një problem i përhapur në komunitetet rome/egjiptiane).

Bashkia ka detyrime të qarta ligjore për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit publik dhe strehimin brenda territorit të saj. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ngarkon bashkisë funksione specifike në këto fusha. Sipas nenit 23 të këtij ligji, bashkia është përgjegjëse për *mbledhjen, largimin dhe trajtimin* e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake në territorin e saj. Ndërkohë, neni 26 i ligjit 139/2015 përcakton se bashkia përgjigjet edhe për *masat e mbrojtjes së mjedisit* në nivel vendor – konkretisht: *mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujërave nga ndotja*. Kjo dispozitë nënkupton se, në parim, bashkia duhet të ndërmarrë veprime për të parandaluar apo zbutur ndotjet mjedisore në zonën e vet. Në rastin konkret, degradimi i çatave prej asbesti që lëshojnë fibra të dëmshme në ajër e truell përbën një ndotje serioze lokale, ndaj Bashkia Berat ka detyrimin ligjor të sigurojë masa mbrojtëse për komunitetin (p.sh. izolimin ose heqjen e materialit të rrezikshëm).

Në kuadrin e menaxhimit të mbetjeve, ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar) konfirmon rolin kryesor të njësive vendore. Neni 21, pika 12 e këtij ligji sanksionon se *kryetarët e bashkive janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e të gjitha mbetjeve të krijuara brenda territorit të tyre*, në përputhje me kërkesat e ligjit. Kjo përcakton përgjegjësinë ligjore të Bashkisë Berat që të trajtojë edhe çështjen e mbetjeve të rrezikshme urbane, siç janë panelet e eternitit të përdorura dikur për çati.

Duhet theksuar se asbesti klasifikohet si mbetje e rrezikshme në përputhje me VKM nr. 402, datë 14.7.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, e cila në Shtojcën I e identifikon me kodin 17 06 05* – “material ndërtimi që përmban asbest”. Shënimi me yll (*) sipas Shtojcës II të kësaj VKM-je nënkupton që mbetja përkatëse konsiderohet si “mbetje e

rrezikshme” në kuptim të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Ky ligj përcakton se mbetjet e rrezikshme janë ato që përmbajnë substanca që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, përfshirë edhe ato me veprim kancerogjen. Në këtë kuadër, çdo trajtim, grumbullim, transport apo asgjësim i asbestit duhet të kryhet në mënyrë të veçantë, në përputhje me rregullat teknike të menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe vetëm nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Ligji ndalon kategorikisht trajtimin e këtyre mbetjeve në të njëjtën mënyrë si mbetjet urbane dhe kërkon hartimin e planeve të posaçme për menaxhimin e tyre si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor.

Pretendimi i vetë bashkisë se “*trajtimi i asbestit është jashtë kapaciteteve operationale*” nuk e shfaqëson nga përgjegjësia ligjore e përcaktuar qartësisht në ligjet e sipërcituara; kjo e fundit, duhet të kërkojë mbështetje financiare nga qeveria qendrore apo fonde emergjente, por jo ta lërë problemin pas dore.

Përtej aspektit mjedisor, Bashkia Berat ka edhe *detyrime sociale* ndaj banorëve të prekur. Kushtetuta (neni 59) dhe ligjet sektoriale kërkojnë nga shteti dhe njësitë vendore të kujdesen për nevojat e strehimit dhe kujdesit shëndetësor të qytetarëve. Në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, bashkitë identifikohen si autoritetet zbatuese të programeve të ndryshme sociale të strehimit. Ky ligj parashikon, ndër të tjera, programin e “*banesës së përkohshme*” për raste emergjente strehimi. Siç përkufizohet në nenin 2 të ligjit, “*banesë e përkohshme*” është *banesa e destinuar për strehim të përkohshëm, në kushtet e emergjencës së strehimit të individëve të pastrehë ose që kanë nevojë për strehim të menjëhershëm dhe me afat të shkurtër, sipas parashikimeve të këtij ligji, derisa t’u zgjidhet mundësia për strehim të qëndrueshëm*. Familjet e ekspozuara ndaj rrezikut kancerogjen nga asbesti padyshim që konsiderohen në “*nevojë për strehim të menjëhershëm*”. Banesat e tyre aktuale janë të rrezikshme për jetën. Në këtë kuptim, Bashkia Berat duhet të ofrojë alternativa për *strehim emergjent* për familjet më të rrezikuara, derisa të realizohet rehabilitimi i çatave të tyre. Ligji i strehimit social i jep përparësi grupeve vulnerabël, ku hyjnë edhe komunitetet rome/egjiptian, madje pika 9 e nenit 77 të këtij ligji thekson se “*... familjet e minoriteteve rome dhe egjiptiane konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit për të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, si dhe për përparësitë ose pikëzimet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në zbatim të këtij ligji.*”

Po ashtu, rreziku i vazhdueshëm nga fibrat e asbestit të pranishme në mjedis, të cilat janë të njohura si substanca kancerogjene (sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Kërkimin mbi Kancerin – IARC), mund të përbëjë një emergjencë mjedisore dhe shëndetësore të natyrës së zgjatur, por me pasoja të rënda dhe të parashikueshme. Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, kjo situatë mund të klasifikohet si rast emergjence, në kuptimin e nenit 3 dhe nenit 29 të këtij ligji. Në këtë kontekst, Kryetari i Bashkisë Berat, në cilësinë e kryetarit të Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile, ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin ligjor për të thirrur këtë komision, me qëllim që të:

- Kryejë një vlerësim zyrtar të rrezikut që paraqet situata dhe të përcaktojë klasifikimin e saj si emergjencë mjedisore/shëndetësore;
- Të koordinojë ndërhyrjen me institucionet përgjegjëse, përfshirë IKMT, Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe strukturat e emergjencave civile;
- Të mobilizojë burimet financiare dhe teknike të disponueshme, si në nivel lokal ashtu edhe me kërkesa specifike në nivel qendror;
- Të hartojë dhe zbatojë një plan ndërhyrjeje urgjente, që përfshin eliminimin e sigurt të asbestit dhe mbrojtjen e banorëve më të ekspozuar ndaj rrezikut.

Për sa më lart, bazuar në kuadrin ligjor, Bashkia Berat duhet të ishte **institucioni iniciator dhe koordinator lokal** për zgjidhjen e problemit, qoftë duke marrë masa vetë, qoftë duke kërkuar ndërhyrjen e agjencive apo institucioneve të specializuara shtetërore, sigurimin e fondeve dhe strehimin e përkohshëm të banorëve.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si autoritet qendror përgjegjës për politikat mjedisore, nuk i është përgjigjur fare kërkesave zyrtare të Avokatit të Popullit (as pas përsëritjes së tyre), duke treguar mungesë bashkëpunimi institucional. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** është autoriteti qendror përgjegjës për politikat mjedisore në Shqipëri. Ligji nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” e përkufizon “ministrinë” si ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe i jep një rol udhëheqës në planifikimin dhe zbatimin e masave mjedisore kombëtare. Sipas nenit 21 të atij ligji, Ministria harton *strategjitë dhe planet kombëtare mjedisore* dhe, kur është e nevojshme, plane sektoriale për çështje specifike. Për më tepër, ministri i Mjedisit ka kompetencë të nxjerrë udhëzime dhe urdhra në zbatim të legjislacionit mjedisor, si dhe të propozojë akte nënligjore në Këshillin e Ministrave. Sipas pikës 4 të nenit 50 të këtij ligji “*ministri miraton ... a) masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar; b) metodën për specifikimin e shpenzimeve për përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe të dëmit.*”. Ministria ka nën varësi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe, deri në vitin 2020, kishte edhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit. Aktualisht, edhe pse funksioni i inspektimit i është transferuar IKMT në varësi të *ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe të ndërtimeve*, politikat mbeten nën drejtimin e Ministrit të Mjedisit. Ministria mund të kërkojë nga IKMT veprime të veçanta inspektuese. Në kushte emergjence mjedisore, ligji i jep Ministrit kompetenca të veçanta: siç u theksua, ai mund të urdhërojë rehabilitimin e menjëhershëm të një zone të ndotur një kompetencë kjo të cilën ky organ administrativ mund t’a ushtrojë në rastin e lagjes “Jani Vruho”,

Sa i përket mosbashkëpunimit me Avokatin e Popullit, theksojmë se ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” i detyron të gjitha organet publike t’i përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit brenda afateve ligjore, duke i vënë në dispozicion informacionet e kërkuara. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nuk pati përgjigje për dy kërkesat zyrtare të Avokatit të Popullit për shpjegime, në shkelje procedurale të detyrimeve ligjore ndaj institucionit kushtetues të Avokatit. Në plan më të gjerë, Kushtetuta e Shqipërisë (neni 15 dhe 59) përcakton se shteti kujdeset për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve dhe për një mjedis të shëndetshëm. Ministri përgjegjës është hallka kryesore ku materializohen këto objektiva kushtetuese në politika konkrete. Mungesa e reagimit nga Ministria e

Turizmit dhe Mjedisit, qoftë me një përgjigje formale ndaj Avokatit të Popullit, qoftë me nisma konkrete në terren, tregon se ky institucion nuk ka përmbushur detyrimin pozitiv që i ngarkon ligji dhe Kushtetuta për të mbrojtur jetën dhe shëndetin publik nga rreziqe mjedisore.

Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) Berat-Elbasan-Korçë, duke iu referuar kompetencave ligjore, është shprehur se mund të veprojë vetëm ndaj subjekteve juridike me leje mjedisore, ndaj dhe e konsideron veten jashtë përgjegjësisë për situatën, duke ia deleguar atë IKMT-së dhe bashkisë. Megjithatë, Agjencia e Mjedisit nuk është tërësisht pa rol. Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) e Qarqeve Berat-Elbasan-Korçë është strukturë lokale nën varësinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), e cila varet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. Kompetencat e kësaj Agjencie përcaktohen në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” (nr. 10431/2011) dhe ligjin “Për lejet e mjedisit” (nr. 10448/2011), si dhe aktet nënligjore përkatëse. Roli kryesor i AKM-së dhe ARM-ve është monitorimi i gjendjes së mjedisit, licencimi (dhënia e lejeve mjedisore) për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis, inspektimi administrativ i aktiviteteve me leje, informimi i publikut, etj. Në praktikë, ARM-të merren kryesisht me subjekte juridike të pajisura me leje mjedisi, çka e ka theksuar edhe vetë Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat-Elbasan-Korçë në përgjigjet e saj drejtuar Avokatit të Popullit. Por, ligji nr. 10431/2011 i ngarkon AKM/ARM, ndër të tjera, me detyrën e këshillimit të organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore. Neni 60, pika 12, gërma “ç” e këtij ligji parashikon se:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione: ... ç) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;

Sa më lat, ARM Berat në këtë situatë vepron si hallkë konsultuese dhe ndërmjetëse. Ajo mund dhe duhet t’i sugjerojë Bashkisë Berat rrugët ligjore dhe teknike për trajtimin e mbetjeve me asbest, të udhëzojë në lidhje me procedurat për dorëzimin e tyre tek kompanitë e autorizuara, apo mundësinë për të kërkuar financime nga pushteti qendror; të raportojë problemin pranë AKM e pranë Ministrisë, duke ushtruar plotësisht misionin e vet si mbrojtëse e mjedisit në nivel lokal, që nënkupton edhe avokim institucional që problemet mjedisore të zgjidhen.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas kërkesës për shpjegime të Avokatit të Popullit, i është drejtuar Inspektoratit Vendor pranë Bashkisë Berat duke kërkuar informacion mbi statusin ligjor të banesave me asbest, por pa ndërmarrë ndonjë veprim tjetër konkret në terren. Nga ana tjetër, nga ana e Inspektoratit Vendor pranë Bashkisë Berat nuk ka përgjigje/reagim për rastin. **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)** është organ qendror i inspektimit me misionin për të kontrolluar dhe mbrojtur territorin dhe mjedisin nga zhvillimet dhe ndërtimet e kundërligjshme, si dhe për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së ajrit, tokës, ujërave dhe peizazhit nga ndotja. Me ndryshimet e fundit në VKM nr. 893/2015 (të përditësuar në 2020),

IKMT ka marrë kompetencat e ish-Inspektoratit të Mjedisit dhe Pyjeve, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e shkëlqeve mjedisore, çka e pozicionon IKMT-në si një aktor të rëndësishëm për situata që përfshijnë ndotje të rrezikshme ose cenim të integritetit të mjedisit – siç është rasti me çatitë që përmbajnë asbest në lagjen “Jani Vruho”. Si inspektorat mjedisor *de facto*, IKMT ka përgjegjësi ligjore të ndërhyjë ndaj çdo ndotjeje apo rreziku mjedisor serioz. Ligji nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (neni 62) përcakton se inspektorati shtetëror kompetent (aktualisht IKMT) siguron *kontrollin shtetëror për mbrojtjen e mjedisit* dhe garanton zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ndër funksionet specifike të inspektoratit mjedisor, ligji rendit dhe hetimin e zonave të ndotura ose potencialisht të ndotura, dhe mbikëqyrjen e masave për rehabilitimin e zonës së ndotur (pika 1/e). Në rastin konkret IKMT është mjaftuar me shkresat formale (drejtuar Inspektoratit Vendor) pa kryer inspektime të mirëfillta mjedisore apo veprime konkrete.

Si rezultat, pavarësisht rrezikut, deri tani nuk ka pasur veprime konkrete për heqjen e asbestit apo strehimin e përkohshëm të familjeve të ekspozuara, ndonëse çdo ditë jetese nën çati me asbest përbën rrezik real për jetën e tyre dhe të fëmijëve. Ato nuk kanë as mjete financiare dhe as mbështetje teknike për ta zgjidhur vetë këtë problem.

Kjo situatë prek drejtpërdrejt një sërë të drejtash themelore të njeriut, në radhë të parë të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe të drejtën për të jetuar në një mjedis të sigurt e të shëndetshëm, të sanksionuara si në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe në instrumente ndërkombëtare.

Nga hetimi administrativ i Avokatit të Popullit, i bazuar në informacionet e marra nga institucionet dhe vëzhgimet në terren, dalin në pah një sërë problematikash, si vijon.

Së pari, situata paraqet **rrezik serioz për jetën dhe shëndetin publik**. Prania e materialeve kancerogjene (asbestit) në çatitë e banesave po ekspozon banorët - përfshirë fëmijë, të moshuar dhe persona vulnerabël - ndaj një rreziku të vazhdueshëm e në rritje, çka cenon drejtpërdrejt detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve të vet. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar se, për shkak të rrezikshmërisë së lartë të asbestit, autoritetet shtetërore kanë detyrim të veçantë të legjislacionit dhe masave praktike për të mbrojtur qytetarët nga ekspozimi ndaj këtij materiali. Ne rastin Brincat kundër Maltës (2014)³, për shembull, Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) dhe nenit 8 (e drejta për jetën private/familjare) të Konventës, me argumentin se shteti kishte dështuar të informonte dhe mbronte efektivisht punonjësit e ekspozuar ndaj asbestit, pavarësisht se rreziku ishte i njohur prej dekadash. Në analogji, mosveprimi ndaj situatës në lagjen “Jani Vruho” ngre pikëpyetje serioze për përmbushjen e këtyre standardeve jetike.

Së dyti, vërehet me shumë shqetësim **mungesë koordinimi dhe shmangie e përgjegjësisë nga institucionet**. Nga hetimi i Avokatit të Popullit ka rezultuar mungesë e theksuar

³ Malta failed to protect ship-yard workers from exposure to asbestos

<https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=003-4832368-5895060&filename=003-4832368-5895060.pdf#:~:text=room%20for%20manoeuvre%20,or%20should%20have%20been%20aware>

përgjegjësie dhe bashkërendimi ndërinstitutional. Çdo institucion lokal apo qendror i shmanget përgjegjësisë direkte, duke e deleguar atë tek institucione të tjera. Kjo qasje fragmentare solli që asnjë organ të mos ndërmarrë veprime konkrete, ndërkohë që rreziku për banorët është i pranishëm dhe urgjent. Kemi të bëjmë me një dështim kolektiv të strukturave shtetërore për t'u përgjigjur ndaj një emergjence mjedisore e shëndetësore. Sjellja e deritanishme - justifikimet me “mungesë kompetencash” apo kapacitetesh - përbën shkelje të parimit të mirëadministrimit dhe cenon besimin e publikut tek institucionet. Ky parim, i njohur si në jurisprudencën evropiane ashtu edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE (neni 41), kërkon nga administrata publike veprim të përgjegjshëm, efektiv dhe të bashkërenduar në shërbim të qytetarit. Në këtë rast, kemi një shembull të keqadministrimit: *institucionet publike jo vetëm kanë dështuar të veprojnë brenda kompetencave të tyre, por nuk kanë ndërmarrë as hapat minimale të nevojshëm për të parandaluar një dëm të parikuperueshëm për shëndetin e komunitetit.*

Vlen të theksohet se edhe organizmat ndërkombëtarë e kanë trajtuar problemin e mungesës së bashkimit institucional në çështjet që prekin komunitetet rome/egjiptiane. ECRI (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës) ka evidentuar raste kur përplasjet e kompetencave dhe neglizhenca institucionale pengojnë zgjidhjen e krizave të strehimit për komunitetet rome/egjiptiane. Në raportin e tij, ECRI ka vërejtur se në raste të ngjashme institucionet publike dështojnë të bashkëpunojnë për të siguruar kushte jetese të denja, duke lënë komunitetin në kushte të rrezikshme, dhe ka rekomanduar gjetjen e zgjidhjeve urgjente⁴. Rasti aktual në Berat pasqyron pikërisht këtë fenomen: instancat shtetërore janë treguar të paafta të veprojnë së bashku për të mirën e qytetarëve në nevojë.

*Së treti, situata përbën **cënim të të drejtave të njeriut për komunitetet vulnerabël.*** Banorët e lagjes “Jani Vruho” i përkasin një komuniteti minoritar (egjiptian), i cili tradicionalisht është përballur me marginalizim dhe kushte të pafavorshme socio-ekonomike. Mospërfillja e kërkesave të tyre për ndihmë dhe mosadresimi i problemit nga institucionet thellon ndjesinë e diskriminimit dhe përjashtimit. E drejta për strehim adekuat dhe standarde minimale të jetesës është një e drejtë ekonomike e sociale e njohur ndërkombëtarisht (neni 11 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore). Komiteti i OKB për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD), në vlerësimet e fundit për Shqipërinë, ka shprehur shqetësim që shumë familje rome dhe egjiptiane vazhdojnë të jetojnë në banesa informale e në kushte të rrezikshme, pa akses në shërbime bazë⁵. CERD ka rekomanduar që shteti shqiptar të marrë masa efektive për të siguruar strehim të përshtatshëm dhe përmirësim të kushteve të jetesës për romët dhe egjiptianët - përfshirë furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime dhe energji elektrike - duke u konsultuar ngushtë me komunitetet e prekura. Gjithashtu, është kërkuar të sigurohet

⁴ ECRI REPORT ON ALBANIA (sixth monitoring cycle) <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241#:~:text=particularly%20disturbing%20that%20in%20both,benefit%20of%20the%20citizens%20concerned>

⁵ United Nations CERD/C/ALB/CO/13-14, International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, Committee on the Elimination of Racial Discrimination, Concluding observations on the combined thirteenth and fourteenth periodic reports of Albania, <https://docs.un.org/en/CERD/C/ALB/CO/13-14>, para.20.

mbrojtja e këtyre familjeve nga dëbimet e detyruara, dhe që në rastet kur zhvendosja është e domosdoshme, të ofrohet strehim alternativ dhe dëmshpërblim i drejtë. Në rastin e lagjes “Jani Vruho”, asnjë nga këto masa nuk është materializuar ende: familjet vazhdojnë të jetojnë nën çati kancerogjene, pa asnjë alternativë tjetër. **Kjo situatë mund të konsiderohet një dështim i autoriteteve shtetërore për të respektuar detyrimet e veta për mbrojtjen e grupeve vulnerabël, siç parashikohet jo vetëm në konventat ndërkombëtare (Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut - ndalimi i diskriminimit), por edhe në Kushtetutën e Shqipërisë (neni 18 garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin).**

Së katërti, një tjetër aspekt shqetësues që del në pah nga hetimi administrativ dhe komunikimi me institucionet përkatëse është **ndjenja e braktisjes** që përjetojnë banorët e lagjes “Jani Vruho”, veçanërisht komuniteti egjiptian që përbën pjesën më të madhe të popullsisë në këtë zonë. Kjo ndjenjë nuk është thjesht një perceptim subjektiv, por një realitet i ndërtuar në mënyrë të vazhdueshme përmes mungesës së vëmendjes institucionale, mosmarrjes së masave konkrete dhe trajtimit të problemit të asbestit si një çështje dytësore. Fakti që banorët janë në dijeni të rrezikut për shëndetin e tyre, por vazhdojnë të jetojnë të ekspozuar ndaj tij pa asnjë garanci, ndërhyrje apo plan për zgjidhje, e përforcon edhe më tej ndjesinë se janë të padukshëm për institucionet shtetërore. Kjo braktisje institucionale reflektohet në mënyrë të veçantë në faktin që, pavarësisht se banorët nuk kanë as mjetet financiare, as njohuritë teknike për të përballuar vetë heqjen e asbestit, që është një proces kompleks dhe i rrezikshëm, ata nuk janë mbështetur as me zgjidhje strehimi alternative, as me asistencë teknike apo ndihmë nga ndonjë program social i dedikuar. Për më tepër, kushtëzimi i çdo ndihme nga ana e Bashkisë me zotërimin e certifikatës së pronësisë përjashton një pjesë të konsiderueshme të këtij komuniteti, duke materializuar një qasje përjashtuese që bie ndesh me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Ndjenja e braktisjes shkon përtej mungesës së ndihmës praktike. Ajo nënkupton humbjen e besimit të komunitetit të shteti, ndjenjën se jetët e tyre kanë më pak rëndësi dhe se fatet e tyre nuk janë prioritet për strukturat publike. Në një shtet të së drejtës, një trajtim i tillë jo vetëm që është moralisht i papranueshëm, por edhe ligjërisht i papajtueshëm me standardet e të drejtave të njeriut, përfshirë detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur individët nga rreziqet serioze për jetën dhe shëndetin, sidomos kur këto rreziqe janë të njohura dhe të parashikueshme. Për rrjedhojë, thellimi i kësaj ndjenje braktisjeje nuk është vetëm një pasojë sociale, por edhe një tregues i dështimit të shtetit për të garantuar përfshirjen, mbrojtjen dhe trajtimin me dinjitet të të gjithë qytetarëve, veçanërisht të atyre që janë në kushte më të pafavorizuara dhe që kanë nevojë për mbështetje të shtuar nga administrata publike. Në këtë kuptim, ajo përbën një alarm serioz që kërkon reflektim dhe veprim institucional të menjëhershëm.

Në vlerësim të përgjithshëm, Avokati i Popullit konstaton se pasiviteti aktual i institucioneve përbën shkelje të parimit kushtetues që detyron shtetin të kujdeset për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare, dhe detyrimet kushtetuese.

Në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut cilësohen si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme”, duke u bërë

bazë e rendit juridik të vendit tonë. Ky përcaktim sanksionon barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Problematika e parashtruar në këtë rast ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës e rrjedhimisht të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “*e drejta për jetën*”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës. Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Neni 18 i Kushtetutës sanksionon se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për çfarëdo lloj arsye, përfshirë racën, etninë, gjuhën, statusin ekonomik etj., duke lejuar masa të veçanta mbrojtëse për grupe specifike kur ka shkaqe objektive. Kjo do të thotë se komuniteti në fjalë, si pakicë vulnerabël dhe në kushte të vështira ekonomike, ka të drejtë të trajtohet me kujdes të veçantë nga autoritetet, dhe çdo neglizhencë ndaj tyre mund të përbëjë diskriminim të tërthortë mbi bazë etnie apo statusi shoqëror. Kushtetuta njeh gjithashtu detyrime sociale të shtetit. Në nenin 59 (objektivat socialë) parashikohet detyrimi për “*plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim*” dhe standarde sa më të larta të kujdesit shëndetësor e mirëqenies. Edhe pse objektivat e nenit 59 nuk janë drejtpërdrejt të kërkueshme në rrugë gjyqësore, ato përbëjnë udhërrëfyes kushtetues për institucionet shtetërore që askush të mos lihet pa strehë dhe kushte minimale jetese. Më tej, Shqipëria është palë në instrumente ndërkombëtare si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i cili garanton të drejtën për një strehim të përshtatshëm dhe një nivel jetese të mjaftueshëm (neni 11). Ky pakt gëzon epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe zbatohet drejtpërdrejt. Mungesa e strehimit adekuat, cenon edhe të drejtën e jetës dhe shëndetit të banorëve - të drejta këto themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe konventat ku Shqipëria aderon.

E drejta për një mjedis të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm po njihet gjithnjë e më gjerësisht si e drejtë themelore e njeriut. Shqipëria, si shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Europës, është e detyruar nga një sërë instrumentesh ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), ndonëse nuk e përmend shprehimisht mjedisin, jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut e ka interpretuar nenin 2 (e drejta për jetë) dhe nenin 8 (e drejta për jetën private dhe familjare) si imponues të detyrimeve pozitive mbi shtetet për të kontrolluar efektet serioze mjedisore që rrezikojnë jetën ose mirëqenien e individëve. Rasti i lartpërmendur *Brincat and Others v. Malta* (2014) vendosi një precedent të rëndësishëm: *kur autoritetet janë ose duhet të jenë në dijeni të një rreziku serioz mjedisor (si ekspozimi kronik ndaj asbestit), ato duhet të marrin masa aktive ligjore dhe administrative për të mbrojtur qytetarët dhe për t'i informuar ata mbi rrezikun*. Mosmarrja e këtyre masave konsiderohet shkelje e Konventës. Po kështu, në raste të tjera (si *Lopez Ostra v. Spain*, *Taşkın v. Turkey*, etj.) Gjykata ka mbajtur shtetet përgjegjëse për dështimin në parandalimin e ndotjeve apo rreziqeve mjedisore që cenojnë shëndetin e popullatës.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 11, sanksionon të drejtën e çdo personi për një standard të përshtatshëm jetese, duke përfshirë strehimin adekuat, dhe neni 12 garanton të drejtën për shëndet. Shqipëria, si palë në këtë Pakt, ka detyrimin të marrë masa për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe mjedisit jetësor,

sidomos për grupet në nevojë. Komiteti i OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR), që mbikëqyr zbatimin e Paktit, në konkluzionet përmbledhëse të shqyrtimit të raportit të katërt periodik të Shqipërisë, në shtator 2024⁶, shpreh shqetësim të veçantë për çështjen e mungesës së strehimit adekuat dhe kushteve të rënda të jetesës për komunitetet rome/egjiptiane, si dhe për masat konkrete për të përmirësuar aksesin në strehim social të këtyre grupeve, priorizimin e familjeve që jetojnë në kushte të rrezikshme, dhe garantimin e fondeve adekuate për këto çështje (duke iu referuar edhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për strehim dhe qytete të qëndrueshme). Edhe çështja e lagjes “Jani Vruho” bie nën vëmendjen e drejtpërdrejtë të angazhimeve të Shqipërisë sipas Paktit.

Shqipëria raporton periodikisht para Komitetit të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e çdo Forme të Diskriminimit Racor (CERD) për përmbushjen e detyrimeve ndaj komuniteteve pakicë. Në Prill të vitit 2024, Komiteti CERD miratoi konkluzionet përfundimtare për Shqipërinë⁷, ku adresoi ndër të tjera situatën e romëve dhe egjiptianëve. Komiteti shprehu shqetësim që disa pjesëtarë të këtyre komuniteteve ende jetojnë në vendbanime informale, me kushte të këqija higjieno-sanitare dhe pa siguri juridike të qëndrimit. Në rekomandime (paragrafi 21), CERD i kërkon Shqipërisë të sigurojë akses në strehim të përshtatshëm për romët dhe egjiptianët, të përmirësojë kushtet e infrastrukturës (ujë, kanalizime, energji) në zonat ku ata banojnë, dhe të garantojë që asnjë familje të mos përjashtohet nga programet e banesave për mungesë dokumentesh. Gjithashtu, theksohet detyrimi për konsultim të mirëfilltë me komunitetet e prekura gjatë hartimit të zgjidhjeve, në mënyrë që të respektohet dinjiteti dhe kultura e tyre. Këto rekomandime janë plotësisht të aplikueshme për situatën e lagjes “Jani Vruho” - zbatimin e tyre nga autoritetet shqiptare duhet të jetë i menjëhershëm dhe i domosdoshëm.

Po gjatë vitit 2024, Shqipëria iu nënshtrua edhe mekanizmit të Rishikimit Periodik Universal në Nëntor 2024 (sesioni i 47-të i Këshillit të OKB për të Drejtat e Njeriut). Gjatë këtij procesi, një numër shtetesh adresuan çështje lidhur me të drejtat e pakicave dhe mjedisin. Delegacioni shqiptar, në fjalën e miratimit të rekomandimeve, deklaroi se *Shqipëria e pranon dhe angazhohet të zbatojë rekomandimet për garantimin e së drejtës për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm*⁸. Po ashtu, u nënvizua fakti që vendi ka miratuar një Plan Kombëtar Veprimi për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (2021-2025) i cili synon, ndër të tjera, përmirësimin e aksesit në strehim për këto komunitete. Përfaqësuesit shqiptarë theksuan gjithashtu se janë marrë angazhime për forcimin e zbatimit të ligjeve

⁶ United Nations E/C.12/ALB/CO/4 Committee on Economic, Social and Cultural Rights Concluding observations on the fourth periodic report of Albania

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/SessionDetails1.aspx?SessionID=2686&Lang=en

⁷ United Nations CERD/C/ALB/CO/13-14, International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, Committee on the Elimination of Racial Discrimination, Concluding observations on the combined thirteenth and fourteenth periodic reports of Albania, <https://docs.un.org/en/CERD/C/ALB/CO/13-14>, para.21.

⁸ UNITED NATIONS HUMAN RIGHTS COUNCIL Adoption of UPR Outcomes #HRC58 • 24 March 2025, fq.3

<https://gchragd.org/wp-content/uploads/2025/02/Albania-UPR-Outcomes.pdf#:~:text=established%20targeted%20programmes%2C%20including%20the,with%20disabilities%20and%20improving%20the>

kundër diskriminimit dhe për mbrojtjen e pakicave. Pranimi i këtyre rekomandimeve në kuadrin e UPR-së do të thotë se qeveria shqiptare është zotuar formalisht në arenën ndërkombëtare që të adresojë probleme si ai që paraqitet në Berat. Implementimi real i tyre kërkon vullnet politik dhe mobilizim të burimeve.

Përveç mekanizmave të mësipërm, edhe organizata si Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit kanë nxjerrë udhëzime mbi rrezikshmërinë e asbestit. OBSh ka deklaruar se nuk ka nivel të sigurt ekspozimi ndaj asbestit dhe ka rekomanduar eliminimin e tij të kontrolluar nga mjedisi i banimit si masë parësore për parandalimin e sëmundjeve kancerogjene⁹.

Në përmbledhje, standardet ndërkombëtare e vendosin qytetarin dhe jetën e tij në qendër. Shteti shqiptar ka detyrimin marrë masa urgjente, proaktive dhe të bashkërenduara për të hequr rrezikun e asbestit nga çatitë e shtëpive në lagjen “Jani Vruho”, për të ofruar mbrojtje shëndetësore dhe strehim për banorët e prekur, si dhe për të garantuar që situata të ngjashme të mos përsëriten.

Në përfundim, Avokati i Popullit vlerëson se situata në lagjen “Jani Vruho” të Beratit është një alarm serioz që kërkon reagim të menjëhershëm, të bashkërenduar dhe efektiv nga të gjitha hallkat institucionale. Ky rast nuk është vetëm një çështje teknike e heqjes së disa pllakave çatie - ai prek dinjitetin njerëzor, barazinë shoqërore dhe besimin e qytetarëve tek shteti. Çdo ditë vonesë është një ditë ku fëmijët marrin frymë pluhur kancerogjen; çdo institucion që pret “të veprojë tjetri” dëmton parimin e unitetit të veprimit shtetëror.

Duke iu referuar edhe angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, veçanërisht në kuadër të procesit të integrimit evropian, sigurimi i kushteve të sigurta të jetesës për qytetarët - pa dallim etnie apo statusi - është kyçi i respektimit të shtetit të së drejtës. Komuniteti egjiptian i Beratit, ashtu si çdo komunitet tjetër, ka të drejtë të jetojë pa frikë për jetën e vet çdo ditë nën çatitë e shtëpive.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, në vijim të nenit 2 të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se “Avokati i Popullit .. është **nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend**” si dhe të nenit 21/b, ku thuhet shprehimisht se “pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: ... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut... ”.

REKOMANDOJMË:

(i) Marrjen e masave nga Bashkia Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Sherbimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat për kryerjen e menjëhershme të

⁹ Chemical Safety and Health, Asbestos, <https://www.who.int/teams/environment-climate-change-and-health/chemical-safety-and-health/health-impacts/chemicals/asbestos>

verifikimit të gjendjes shëndetësore të banorëve në banesat me çati të mbuluara me material asbesti, dhe ofrimin e kujdesit dhe trajtimit të nevojshëm shëndetësor;

(ii) Të gjitha institucionet publike të përfshira në këtë çështje të marrin masa konkrete, në mënyrë të bashkërenduar dhe të menjëhershme, për ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune për identifikimin e të gjitha banesave me çati me përmbajtje asbesti si dhe planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve të specializuara për heqjen e sigurt të asbestit, sipas standardeve teknike ndërkombëtare;

(iii) Për periudhën tranzitore të heqjes së asbestit të ofrohet mundësi alternative strehimi për banorët e rrezikuar;

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”, lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.